



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP Anr.67/2026

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Arsim Hamzaj - kryesues, Kymete Kicaj, dhe Skender Cocaj - anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesat e Koalicionit, PAI - PDAK - LPB, të parashtruara kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, për shkak të shpalljes së pavlefshme të fletëvotimeve gjatë numërimit të votave në Qendrën e Numërimit të Rezultateve (QNR) në Prishtinë, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 28 dhjetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë **08.01.2026**, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHEN të pa bazuara ankesat ZP.Anr.67/2026, dhe ZP.Anr.68/2026 të datës 05.01.2026, të parashtruara nga subjekti politik, Koalicioni PAI - PDAK - LPB, kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, për shkak të shpalljes së pavlefshme të fletëvotimeve, gjatë numërimit të votave në Qendrën e Numërimit të Rezultateve (QNR) në Prishtinë, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 28 dhjetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 05.01.2026, PZAP-i, ka pranuar dy ankesa nga Koalicioni, PAI - PDAK - LPB me numër protokolli ZP. Anr. 67/2026 dhe ZP. Anr.68/2026.

Në ankesën ZP. Anr. 67/2026 theksohet se Koalicioni PAI-PDAK-LPB, parashtron këtë ankesë lidhur me shpalljen e pavlefshme të një (1) fletëvotimi në vendvotimin VP13/03, gjatë procesit të numërimit të votave. Në fletëvotimin e kontestuar janë konstatuar këto fakte: është shënuar vetëm një subjekt politik, përkatësisht Koalicioni PAI – PDAK - LPB (nr.125). Shenja e votimit është vendosur qartë brenda kutisë përkatëse; Nuk ekziston asnjë shenjë tjetër, korrigjim shtesë apo element që do ta bënte votën të paqartë apo të dykuptimtë. Sipas informatave të vëzhguesve tanë, arsyeja e shpalljes së pavlefshme nga ana e numëruesve ka qenë se fletëvotimi është prekur me korrektor. Megjithatë, duhet theksuar se votuesit nga

diaspora, në rast gabimi, nuk kanë pasur mundësi të ndërronin fletëvotimin, andaj përdorimi i korrektorit ka qenë mjeti i vetëm për korrigjim. Shënimi është bërë në formën ndërsa orientimi dhe qëllimi i votuesit janë të qarta, të lexueshme dhe të padiskutueshme. Në këtë rast, shpallja e fletëvotimit si i pavlefshëm përbën një qasje tejet formaliste, e cila cenon parimin themelor të ruajtjes dhe mbrojtjes së vullnetit të lirë të votuesit. Duke u mbështetur në parimin kushtetues të respektimit të vullnetit të qytetarit dhe në praktikën zgjedhore që favorizon vlefshmërinë e votës kur qëllimi i votuesit është i qartë, kërkoj nga PZAP që: Të rishqyrtojë vendimin për shpalljen e pavlefshme të këtij fletëvotimi në vendvotimin VP 13/03; Ta shpallë atë fletëvotim të vlefshëm dhe ta numërojë në favor të Koalicionit PAI-PDAK-LPB. Si dëshmi, ka bashkëngjitur fotografimin e fletëvotimit.

Në ankesën ZP. Anr. 68/2026 theksohet se Koalicionit PAI – PDAK - LPB, parashtrohet këtë ankesë lidhur me shpalljen e pavlefshme të një (1) fletëvotimi në vendvotimin VP22/02, gjatë procesit të numërimit të votave. Në fletëvotimin e kontestuar është shënuar vetëm një subjekt politik, përkatësisht Koalicioni PAI-PDAK-LPB (nr. 125); Shenja është vendosur qartë brenda kutisë përkatëse; Nuk ka asnjë shenjë tjetër, asnjë korrigjim dhe asnjë element që do ta bënte votën të paqartë apo të dykuptimtë. Arsyeja e shpalljes se pavlefshme sipas vëzhguesit tanë nga numëruesit ka qenë se fletëvotimi ka qenë i prekur me korrektor, mirëpo duhet kuptuar që diaspora në rast gabimi nuk e ka pasur mundësinë ta ndërrojë fletëvotimin andaj është përdorur. Shënimi është bërë në formën "X", orientimi dhe qëllimi bazë i votuesit janë të qarta, të lexueshme dhe të padiskutueshme. Në këtë rast, shpallja e fletëvotimit si i pavlefshëm përbën një qasje formaliste, e cila cenon parimin themelor të mbrojtjes së vullnetit të lirë të votuesit. Duke u mbështetur në parimin kushtetues të ruajtjes së vullnetit të qytetarit dhe në praktikën zgjedhore që favorizon vlefshmërinë e votës kur qëllimi i votuesit është i qartë, kërkoj nga PZAP që: Të rishqyrtojë vendimin për shpalljen e pavlefshme të këtij fletëvotimi në vendvotimin VP22/02; Ta shpallë atë të vlefshëm dhe ta numërojë për Koalicionin PAI – PDAK - LPB. Si dëshmi, ka bashkëngjitur fotografimin e fletëvotimit.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur nga KQZ-ja, theksohet se pas shqyrtimit të ankesës dhe pretendimeve të palës ankuese në lidhje me kërkesën e juaj jep sqarimet/përgjigjet si më poshtë: Gjatë procesit të verifikimit dhe numërimit të fletëvotimeve në QNR, vlejné procedurat e numërimit në VV, sipas Rregullores Zgjedhore Nr.12/2024 për Votimin, Numërimin në Vendvotim dhe Menaxhimin e Vendvotimit. Neni 16 paragrafi 2 i Rregullores së lartcekur, thekson se: Vota është e vlefshme, kur votohet vetëm një subjekt politik dhe kuptohet qartë qëllimi i votuesit: Në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, vota konsiderohet e vlefshme nëse votuesi ka votuar për një (1) subjekt politik. Po, ashtu bazuar në të lartcekurat dhe duke u mbështetur në nenin 16 paragrafi 2.2 të Rregullores Zgjedhore Nr. 12/2024 Votimi, Numërimi Në Vendvotim dhe Menaxhimi i Vendvotimit, vota konsiderohet e pavlefshme, në rastet kur: Kur votohet më shumë se një subjekt politik; kur nuk votohet asnjë subjekt politik; kur votohen vetëm kandidatët dhe jo subjekti politik; kur qëllimi i votuesit nuk është i qartë, sipas procedurave të votimit dhe numërimit në vendvotim. Gjatë numërimit të fletëvotimeve në QNR, vlefshmëria e fletëvotimeve dhe votave përcaktohet sipas nenit 16 të Rregullores Zgjedhore Nr.12/2024, e cila rregullon procesin e

votimit, numërimit dhe menaxhimit të vendvotimit. Në lidhje me pretendimet e palës ankuese se fletëvotimi është shpallur i pavlefshëm, në procedurën e votimit dhe numërimit në vendvotim, të miratuar nga KQZ, janë paraparë shembujt e fletëvotimeve të vlefshme dhe të pavlefshme. Si dëshmi kanë bashkangjitur shembujt të fletëvotimeve të vlefshme dhe të pavlefshme për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Paneli, në kuptim të nenit 6 paragrafi 6 të Rregullores për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar ankesat ZP.A.nr.67/2026 dhe ZP.A.nr.68/2026 të datës 05.01.2026, të njëjtat janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjën e përbashkët ZP.A.nr.67/2026, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankuesit.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoi pretendimet ankimore, përgjigjet në ankesë ka gjetur se:

- Ankesat janë të pa bazuara.

Paneli vlerësoi se janë të pabazuara pretendimet e parashtruara në ankesë nga Koalicioni, PAI - PDAK - LPB, me të cilën pretendon se në Qendrën e Numërimit të Rezultateve (QNR) në Prishtinë, gjatë procesit të numërimit të votave, një (1) fletëvotim nga vendvotimi VP13/03 dhe një (1) fletëvotim nga vendvotimi VP22/02, i janë shpallur të pavlefshme nga komisionerët përkatës. Paneli ka gjetur se nga fotot e bashkangjitura si prova në ankesën ZP Anr 67/2026 dhe ZP Anr 68/2026 shihet se në këto dy fletëvotimet, tiku -X janë të vendosura në katrorin e numrit 125 Koalicioni, PAI - PDAK - LPB, ndërsa tiku-X tjetër kanë qenë të vendosura tek numri 126 Socialdemokratska Unija SDU, me çka në të dy fletëvotimet është ndërhyrë me korrektor duke i shlyer ato. Andaj nga shikimi i këtyre fotove shihet se në këto fletëvotime ka pasur ndërhyrje me korrektor dhe të njëjtat janë shpallur të pavlefshme me të drejtë në QNR-KQZ, pasi që kjo ndërhyrje e ka bërë të paqartë vullnetin e votuesit dhe nga kjo ndërhyrje që janë bërë në këto fletëvotime nuk mund të konsiderohet se është votuar vetëm Koalicioni, PAI - PDAK - LPB, dhe kandidatët e saj për të cilën pretendon pala me ankesë.

Në nenin 16 paragrafi 2 të Rregullores Zgjedhore Nr.12/2024 Votimi, Numërimi në Vendvotim dhe Menaxhimi i Vendvotimit, në zgjedhjet për Kuvendin e Komunës në mënyrë decisive thuhet se *“vota është e vlefshme, kur votohet vetëm një subjekt politik dhe kuptohet qartë qëllimi i votuesit”* Ndërsa në nenin 16 par.2.2 të të njëjtës Rregullore, vota konsiderohet e pavlefshme, në rastet kur : *Kur votohet më shumë se një subjekt politik; kur nuk votohet asnjë subjekt politik; kur votohen vetëm kandidatët dhe jo subjekti politik; kur qëllimi i votuesit nuk është i qartë, sipas procedurave të votimit dhe numërimit në vendvotim.*

Prandaj bazuar në dispozitat e lartcekura dhe duke u mbështetur në nenin 117 paragrafi 3 të LZP-së, në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se *“Vendosja për ankesat*

nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse", Paneli vlerësoi se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoi, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesa, dhe nga provat e ofruara si dëshmi, parashtuesi i ankesave nuk ka arritur që të vërtetoj pretendimet e tij, pasi që nga provat e ofruara shihet qartë se fletëvotimet në fjalë nuk janë plotësuar sipas rregullave të votimit si dhe sipas dispozitave të sipërcituara, pasi që nuk mund të dihet qartë qëllimi i votuesit dhe mbi këtë bazë këto fletëvotime nuk mund të konsiderohen të vlefshme.

Paneli gjatë vendosjes së ankesave i ka shqyrtuar dhe analizuar me kujdes të gjitha provat dhe ka vërtetuar në mënyrë të plotë se pretendimet ankimore janë të pa bazuara në ligj, andaj ankesat u refuzuan të pa bazuara në kuptim të nenin 117 paragrafi 3, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, dhe mbi këtë arsye Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZP. Anr.67/2026, datë 08.01.2026



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.